

Këshillimi Hershëm Logopedik bëhet tek fëmijët nga moshë 2 vjeçare e deri sa të futen në kopsht(Kindergarten),nëse tek këta fëmijë paraqiten probleme në të folur.

### **Kur duhet t'i drejtoheni Këshillimit të Hershëm Logopedik?**

- nëse të folurit e fëmijës tuaj nuk i përgjigjet moshës që ka
- nëse fëmija pyet shpesh dhe ju mendoni se ai nuk dëgjon mirë
- nëse fëmija tërhiqet në vetëvete përshkak që të tjerët nuk e kuptojnë
- nëse fëmija kur flet bëlbëzon ose ngutet
- nëse fëmija flet vetëm në shtëpi por jo edhe jashtë saj
- nëse personat tjerë nuk e kuptojnë mirë fëmijën tuaj se çfarë flet

### **Çka përfshin oferta jonë?**

#### **Diagnostifikimi**

Nëse fëmija juaj është lajmëruar në LFS (Logopedi), sëpari do të sqarohen shkaqet (bëhet diagnostifikimi). Bazën për këtë diagnostifikim e përbëjnë vëzhgimi i lojës së përbashkët të terapistes me fëmijën si psh. kontakti, format komunikative, vetëbesimi, përmajtja e lojës, zhvillimi motorik dhe mënyra se si i kap (përcepton) fëmija gjërat. Pastaj në bisedë me prindërit do të hidhet dritë mbi vëzhgimet që janë bërë dhe do t'u tregohet prindëve për mundësitë dhe rrugët që duhet ndjekur.

#### **Terapia**

Nëse është e nevojshme që fëmija e juaj të bëjë terapi atëherë pason faza e parë (3-4 muaj) me dy herë në javë terapi. Qëllimi i terapisë është që tek fëmija të zgjohet interesimi dhe gëzimi për lojë dhe të forcohet ndjenja e vetëvlerësimit dhe punës së pavarur. Kështu fëmija duhet ta kuptojë se sa e rëndësishme është të shprehurit e asaj që ndjen dhe njëkohësisht që të të kuptojnë dhe t'i kuptosh të tjerët.

#### **Këshillimi**

Këshillimi kryesisht u drejtohet prindërve por ka mundësi të zgjerohet edhe tek personat e tjerë që shoqërojnë dhe mbikqyrin zhvillimin e fëmijës. Baza e këtij këshillimi është të folurit hapur për problemet, respekti dhe besimi reciprok i treguar gjatë punës së përbashkët me prindërit.

Veç kësaj egziston mundësia që ofertën për këshillim ta shfrytëzoni edhe për t'i sqaruar pyetjet tuaja specifike.

### **Si bëhet lajmërimi në Këshillimore ?**

Lajmërimi në Këshillimore mund të bëhet direkt nga prindërit, fëmija dhe mjeku shtëpiak ose nga qendra tjera profesionale, por pasi ta kenë marrë pëlqimin(miratimin)e prindërve.

### **Kur është koha e duhur për lajmërim?**

Që t'i iket presionit kohor duhet të bëhet sa me herët sqarimi dhe konsultimi i plotë problemit. Efikase do të jetë terapia e cila ka dy faza duke përfshirë dhe pauzën. Që terapia të jetë sa me e sukseshme fëmija duhet të jetë i moshës 24-36 muajshe. Prindërit e fëmijëve të lajmëruar me vonesë sipas rregullit vetëm do të shoqërohen duke u konsultuar njëkohësisht.

### **Kush merr përsipër pagesën?**

Pagesën për diagnostifikim, terapi dhe këshillim do ta paguajë Kantoni i Schaffhausen-it, për aq kohë sa fëmijët banojnë në këtë Kanton.